

V E N D I M
Nr.136, datë 25.3.1994

**PËR SHITESËN NE PAGË PËR VËSHITRËSI SHËRBIMI TË PUNONJËSVE QË PUNOJNË
DREJTPERDREJT ME FEMIJET DHE NXËNËSIT NË SISTEMIN E ARSIMIT**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Punonjësve që punojnë drejtpërdrejt me fëmijët dhe nxënësit në sistemin e arsimit, i jepet shtesë për vështirësi shërbimi mbi pagën bazë ekzistuese 140 lekë në muaj (baras me 5 për qind të pagës bazë të vitit 1993), sipas emërtimeve të mëposhtme:

- mësues në arsimin 8- vjeçar, të mesëm, në institutet e fëmijëve me të meta fizike e mendore;
- edukatore në kopshtet e fëmijëve;
- instruktor në qendrat kulturore të fëmijëve;
- edukator dhe kujdestar konvikti;
- drejtuesit e kopshteve, të shkollave, bazave prodhuese, poligonit mësimor, qendrave kulturore të fëmijëve dhe instituteve të fëmijëve me të meta fizike e mendore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 shkurt 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi